



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
APELACIONI SUD KOSOVO – THE APPELLATE COURT OF KOSOVO

---

**Gjykata e Apelit e Republikës së Kosovës**  
**shpall :**  
**Thirrje për rekrutim**  
**Nr. 01/2019**

**Titulli i vendit të punës:** Praktikant/ë vullnetar/e 35 pozita

**Nëpunësi mbikëqyrës:** Administratori i Gjykatës

**Kohëzgjatja e emërimit:** Me afat të caktuar, në kohëzgjatje prej një viti (pa pagesë)

**Vendi:** Gjykata e Apelit Prishtinë

**Përshkrimi i detyrave të punës:**

**Detyra e praktikantit:** Ndhmon zyrën e administratës në organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe menaxhimin e tyre në përgjithësi.

**Detyrat kryesore:**

Vepron në mbikëqyrjen e drejtpërsëdrejti të kryetarit të Gjykatës dhe nën mbikëqyrjen e përgjithshme të administratorit të Gjykatës;

Ndhmon punën në zyrën e administratës lidhur me organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe në menaxhimin e tyre në përgjithësi;

Ndhmon gjyqtarët në punë që kanë të bëjnë me futjen e lëndëve në dosje;

Ndhmon në punën e zyrave të ndryshme në Gjykatë, duke përfshirë regjistrimin, hetimet, gjykimet etj; Kryen edhe punë tjera sipas nevojës:

**Kualifikimet:**

- Diploma e Fakultetit Juridik programi i studimeve (4) vjeçar apo 240 kredi ECTS ose Mastër,
- Njohuri të procedurave gjyqësore;
- Aftësi për kryerjen e hulumtimeve gjyqësore (juridike);
- Njohuri të mjaftueshme ligjore;
- Aftësi të shkëlqyeshme në përpilimin me shkrim të drafteve juridike, duke përfshirë aftësinë në përpilimin e dokumenteve ligjore, si dhe shkathtësi komunikimi në të folur.

**VEREJTJE:**

- Procedura është e hapur për kandidatët të jashtëm dhe nëpunësit civil ekzistues.
- Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara në Rregulloren e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës Nr.08/2017.

• **Thirrja është publikuar më dt. 10.01.2019 dhe mbyllet me dt. 25.01.2019**

**Aplikacionet mund t'i merrni dhe t'i dorëzoni në Gjykatën e Apelit të Kosovës-Pallati i Drejtësisë, objekti B- Lagjja “Prishtina e Re”, Rr.:" Nekibe Kelmendi” pn.**

+381 (0) 38/200 18 788, ose ne web portalin tone [www.gjyqesori-rks.org](http://www.gjyqesori-rks.org)

[Shkarko Aplikacionin](#)